



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

RAPORTI VJETOR I PUNËS

VITI 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje.....	3
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
3. MBLEDHJET DHE VENDIMET E BORDIT DREJTUES	7
3.1 Vendimet e Bordit Drejtues gjatë vitit 2025	8
4. REALIZIMI I PLANIT VJETOR TË PUNËS (VENDIMI 11-BD-2025)	13
5. ANËTARËSIMI, LICENCIMI DHE SIGURIMI PROFESSIONAL.....	18
5.1 Anëtarët e licencuar	19
5.2 Regjistrimi i praktikantëve	21
5.3 Sigurimi i përgjegjësisë profesionale.....	22
5.4 Zgjerimi i fushëveprimit të licencimit	22
5.5 Fillimi i shpërndarjes së licencave të para profesionale	22
6. DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE – PLATFORMA ELICENCA.....	23
6.1 Takimet dhe Punëtoritë për platformën eLicenca	23
6.2 Prezentimi përfundimtar në GIZ	24
7. EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (EVP)	25
7.1 Trajnimi i parë – Statuti dhe Rregulloret e OIRK	26
7.2 Trajnimi i dytë – Ligji i Ndërtimit dhe procedurat e lejes ndërtimore	26
7.3 Trajnimi i tretë – Shëndeti dhe siguria në punë në ndërtim.....	26
7.4 Vlerësim dhe planifikim për EVP	27
8. RREGULLORET DHE AKTET E BRENDSHME.....	28
9. MEMORANDUMET E MIRËKUPTIMIT DHE BASHKËPUNIMIT	29
10. KOMISIONET DHE TRAJTIMI I LËNDËVE	31
10.1 Komisioni i Ankesave	31
10.2 Komisioni Disiplinor.....	31
11. TAKIMET DHE AKTIVITETET KRYESORE GJATË VITIT	32
11.1 Takime për funksionalizimin e OIRK dhe licencimin	32
11.2 Takime me institucione shtetërore dhe rregullatore	33
11.3 Takime me odat dhe shoqatat profesionale	34
11.4 Takime me përfaqësi diplomatike dhe organizata ndërkombëtare	34
12. RAPORTI FINANCIAR.....	35
13. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM DHE REKOMANDIMET	36
REKOMANDIMET DHE DREJTIMET STRATEGJIKE PËR VITIN 2026	38

1. HYRJE

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) është themeluar dhe funksionon në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-012 “Për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit” dhe Statutit të Odës së Inxhinierëve për periudhën e përkohshme. Raporti vjetor paraqet punën e organeve të OIRK-së gjatë vitit kalendarik, me fokus në:

- realizimin e Planit Vjetor të Punës, të miratuar me vendimin nr. 11-BD-2025 të Bordit Drejtues;
- ngritjen e kapaciteteve institucionale të Odës;
- licencimin dhe rregullimin e profesionit të inxhinierit në fushën e ndërtimit;
- bashkëpunimin ndërinstitutional dhe digjitalizimin e shërbimeve.

Ky është raporti i parë vjetor i punës, i prezantuar në Kuvendin e OIRK-së, pas themelimit të saj. Viti i parë i funksionimit ka qenë një periudhë e mbushur me sfida të natyrës organizative, operacionale dhe infrastrukturore, të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në procesin e konsolidimit të institucionit.

Në fazën fillestare, OIRK është përballur me vonesa në sigurimin e hapësirave të punës, ku edhe zyrat e përkohshme të vendosura në kontejnerë – të siguruar me vonesë nga Ministria përgjegjëse – nuk ofronin kushte adekuate për zhvillimin normal të punës. Këto hapësira provizore u shoqëruan me sfida të theksuara, sidomos gjatë periudhës së verës, kur temperaturat e larta dhe mungesa e një sistemi funksional të klimatizimit e bënë shumë të vështirë qëndrimin dhe punën e stafit. Situata u stabilizua vetëm pasi OIRK investoi në vendosjen e pajisjeve të reja të klimatizimit, duke krijuar kushte minimale të nevojshme për funksionim.

Pajisja e zyrave me inventar bazik, përfshirë tavolina, karrige dhe mjete të tjera të punës, u përcoll me vonesa dhe vështirësi logjistike. Po ashtu, krijimi i kushteve themelore të funksionimit, si vendosja e lidhjes së internetit dhe aktivizimi i linjave telefonike, mori kohë dhe paraqiti sfidat e veta teknike dhe procedurale, duke e vështirësuar komunikimin institucional gjatë muajve të parë të punës.

Në aspektin financiar, sfida e rëndësishme ishte vonesa në realizimin e grantit fillestar për funksionalizimin e Odës, i cili u ekzekutua vetëm në muajin prill. Deri në atë periudhë, puna e Odës u mbështet kryesisht në përkushtimin dhe vullnetin e anëtarëve të Bordit, të cilët zhvilluan dhjetëra takime në ambiente të ndryshme të ofruara vullnetarisht, si hapësira të Fakultetit Teknik, restorante dhe zyra të anëtarëve të ndryshëm, duke siguruar që proceset të mos ndaleshin.

Rekrutimi i stafit administrativ u realizua me vonesë, ku tre zyrtarët e administratës filluan punën me 2 maj, ndërsa drejtori ekzekutiv u angazhua më 12 maj. Pikërisht në këtë periudhë filloi edhe procesi i aplikimeve për licencim, i cili solli një fluks shumë të madh të aplikuesve, për shkak të hyrjes në fuqi të zbatimit të ligjit nga data 30 maj. Kjo gjeneroi presion të konsiderueshëm mbi kapacitetet ende të pakonsoliduara të Odës.

Sfida u paraqitën edhe në procesin e prodhimit të licencave, ku operatori i caktuar nga MMPHI hasi në vonesa të mëdha dhe gabime teknike në materialet e prodhuara (përfshirë paragonat dhe QR-kodet). Problemi u tejkalua pasi OIRK angazhoi një kompani të specializuar, duke siguruar një proces të rregullt dhe cilësor të prodhimit të licencave.

Me hyrjen në fuqi të aplikimit të licencimit më 30 maj, në mbështetje të Qarkores së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), organet e Odës kanë ndërmarrë një sërë veprimesh intensive për informimin dhe ndërgjegjësimin institucional lidhur me zbatimin e Ligjit për Odat. Në këtë kuadër, OIRK ka njoftuar zyrtarisht të gjitha institucionet publike qendrore (ministritë, Zyra e Kryeministrit), të gjitha komunat e Republikës së Kosovës (përfshirë kryetarët e komunave), institucionet publike të pavarura, si dhe institucionet dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, duke i informuar se ushtrimi i profesionit të inxhinierit në fushën e ndërtimit nuk lejohet pa licencë valide pas datës 30 maj. Fillimisht, zbatimi i këtij detyrimi ligjor nuk ka qenë i menjëhershëm dhe as i njëtrajtshëm në të gjitha institucionet, por ka nisur gradualisht në disa prej tyre. Pas zhvillimit të takimeve me institucione kyçe, përfshirë Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), dhe pas lidhjes së memorandumit të bashkëpunimit, është shënuar një përmirësim i pjesshëm i zbatimit të kërkesës për përfshirjen e inxhinierëve të licencuar në dosjet tenderuese, megjithëse jo në nivel të kënaqshëm. Më tej, OIRK ka intensifikuar fazën e dytë të informimit, duke njoftuar drejtoritë komunale të urbanizmit dhe inspektoratet në të gjitha komunat, si dhe inspektoratet përgjegjëse për rolin dhe domosdoshmërinë e angazhimit të inxhinierëve të licencuar në proceset e mbikëqyrjes dhe inspektimit ndërtimor, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse. Institucionet janë informuar gjithashtu për pasojat ligjore dhe institucionale që mund të lindin nga mosrespektimi i Ligjit për Odat. Organet e Odës kanë qenë aktive gjatë gjithë vitit përmes shkresave zyrtare, thirrjeve për takime dhe komunikimeve të vazhdueshme ndërinstitucionale, me qëllim shtrirjen sa më të gjerë të zbatimit të ligjit. Ky proces ka qenë veçanërisht sfidues gjatë këtij viti, për shkak të mungesës së një qeverie qendrore funksionale për pjesën më të madhe të vitit, si dhe për shkak të zhvillimit të zgjedhjeve lokale, faktorë këta që kanë ndikuar në ngadalësimin e zbatimit të Ligjit për Odat. Aktualisht, OIRK ndodhet në prag të nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit, i cili pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në forcimin dhe shtrirjen më të gjerë të zbatimit të Ligjit për Odat në të gjitha institucionet, si në nivel qendror ashtu edhe lokal.

Megjithë këto sfida që i karakterizuan ekskluzivisht vitin e parë të themelimit, përkushtimi, profesionalizmi dhe angazhimi i anëtarëve të Bordit dhe stafit administrativ mundësuan konsolidimin e funksioneve bazë të Odës dhe vendosjen e themeleve për një institucion të qëndrueshëm, transparent dhe funksional. Këto përvoja përbëjnë bazën e zhvillimit të mëtejshëm institucional dhe të avancimit të rolit të OIRK-së në rregullimin dhe mbështetjen e profesionit të inxhinierit në vend.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit raportues, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) ka shënuar një progres të dukshëm në konsolidimin institucional dhe në forcimin e rolit të saj si autoritet publik përgjegjës për rregullimin e profesionit të inxhinierit në fushën e ndërtimit, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012 dhe Statutin e OIRK-së. Përmes një angazhimi të vazhdueshëm në qeverisjen profesionale, licencimin e inxhinierëve, ngritjen e kapaciteteve dhe edukimin e vazhdueshëm, si dhe përmes bashkëpunimit të strukturuar me institucionet shtetërore, sektorin akademik dhe organizatat profesionale brenda dhe jashtë vendit, OIRK ka krijuar themele të forta për një funksionim të qëndrueshëm, efikas dhe transparent.

Rezultatet e arritura gjatë vitit reflektojnë jo vetëm zbatimin e objektivave operacionale, por edhe orientimin strategjik të Odës drejt standardizimit të profesionit të inxhinierit në fushën e ndërtimit, digjitalizimit të proceseve, forcimit të mekanizmave rregullatorë dhe zgjerimit të fushëveprimeve profesionale në përputhje me nevojat e tregut dhe me zhvillimet teknike e teknologjike. Këto arritje e pozicionojnë OIRK-në si një institucion stabil dhe të gatshëm për të avancuar më tej proceset reformuese dhe për të përmbushur mandatin e saj ligjor në shërbim të interesit publik dhe komunitetit inxhinierik të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit raportues, OIRK ka arritur këto rezultate kryesore:


- Janë mbajtur 51 mbledhje të Bordit Drejtues, ku janë miratuar 48 vendime, të cilat janë realizuar plotësisht. Po ashtu, janë mbajtur edhe rreth 10 mbledhje dhe takime të përbashkëta, në kuadër të të cilave janë zhvilluar diskutime dhe koordinime me Komisionin e Ankesave, Komisionin Disiplinor, grupet punuese për përgatitjen e Qmimore referente minimale, Odën e Arkitektëve të Kosovës (OARK), si dhe me kompaninë përkatëse dhe MMPHI-në në kuadër të procesit të digjitalizimit, si dhe takime të tjera të natyrës bashkëpunuese.
- Plani Vjetor i Punës (pikat 1–22) është realizuar në tërësi gjatë vitit 2025, ndërsa vetëm pika 16 (ndarja e çmimeve dhe mirënjohjeve) është planifikuar që në fillim të vitit 2026 të iniciohet thirrja për aplikim, pas përzgjedhjes, ndarja e çmimeve do bëhet në kuadër të Ditës së Inxhinierit 4 Mars 2026.
- Janë anëtarësuar dhe licencuar rreth 1082 anëtarë të rinj, ndërsa ka filluar edhe regjistrimi i praktikantëve dhe deri më tani janë regjistruar 11 anëtarë.
- Ka nisur implementimi i sigurimit të përgjegjësisë profesionale për inxhinierët e licencuar, në përputhje me rregulloren përkatëse.
- OIRK ka organizuar tre trajnime të para të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP), duke siguruar realizimin e 8 pikëve minimale për vitin e parë të funksionimit.
- Është miratuar Rregullorja e Punës së Bordit Drejtues, ndërsa janë hartuar draft Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe Rregullorja e Punës së Administratës, të cilat paraqiten për miratim në Kuvend.
- Janë nënshkruar 12 Memorandume të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare.
- Janë zhvilluar një numër i madh takimesh strategjike me institucione qendrore, komuna, odat profesionale, akademinë dhe biznesin, brenda dhe jashtë vendit.

- Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në digjitalizimin e shërbimeve, duke përfshirë takime dhe punëtori si dhe realizimi i prezantimit final të platformës eLicenca në GIZ që shumë shpejt pritet të implementohet.
- Bordi Drejtues ka miratuar zgjerimin e fushëveprimit të licencimit duke përfshirë edhe drejtime të reja inxhinierike (gjeodezi, gjeoteknikë, gjeologji, etj.), me afat zbatimi nga 1 janari 2026.
- Është përfunduar Dokumenti për Çmimet Referente Minimale në fushën e ndërtimit dhe shërbimeve inxhinierike, i cili bashkëngjitet si rezolutë për miratim në Kuvend.
- OIRK ka filluar shpërndarjen e licencave të para profesionale, duke shënuar konsolidimin praktik të procesit të licencimit dhe ushtrimit të rregulluar të profesionit të inxhinierit në Republikën e Kosovës.

3. MBLEDHJET DHE VENDIMET E BORDIT DREJTUES

Gjatë vitit raportues, Bordi Drejtues i OIRK-së ka ushtruar një rol qendror dhe aktiv në drejtimin strategjik dhe operacional të Odës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-012 dhe Statutin e OIRK-së. Nëpërmjet mbledhjeve të rregullta dhe trajtimit sistematik të çështjeve me rëndësi për funksionimin e institucionit, Bordi ka siguruar zbatim të politikave dhe akteve të përgjithshme të Odës, funksionalizim të qëndrueshëm të administratës dhe zhvillim të proceseve kyçe si licencimi, edukimi i vazhdueshëm profesional dhe standardizimi i shërbimeve për anëtarët.

Aktiviteti	Numri
Mbledhje të Bordit Drejtues	54
Vendime të miratuara	49
Memorandume Bashkëpunimi	12



Vendimmarrjet e miratuara gjatë vitit pasqyrojnë angazhimin e Bordit në konsolidimin e strukturave të brendshme, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe avancimin e bashkëpunimeve profesionale me palë vendore dhe ndërkombëtare. Rezultatet e paraqitura më poshtë ofrojnë një përmbledhje të veprimtarisë kryesore të Bordit Drejtues dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e OIRK-së gjatë këtij viti.

Gjatë vitit raportues:

- Bordi Drejtues ka mbajtur gjithsej **54 mbledhje**, me pjesëmarrje të rregullt të anëtarëve dhe rend dite të strukturuar.
- Janë miratuar **49 vendime**, të cilat kanë mbuluar, ndër të tjera:
 - o miratimin e Planit Vjetor të Punës (vendimi 11-BD-2025);
 - o miratimin e Rregullores së Punës së Bordit;
 - o procedurat e licencimit dhe të EVP-së;
 - o zbatimin e sigurimit të përgjegjësisë profesionale

- o propozimin e rregulloreve të reja;
- o inicimin dhe miratimin e Memorandumeve të Bashkëpunimit;
- o masat lidhur me funksionalizimin e plotë të administratës dhe shërbimeve të OIRK-së.

3.1 Vendimet e Bordit Drejtues gjatë vitit 2025

Gjatë vitit raportues, Bordi Drejtues i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës ka ushtruar kompetencat e tij ligjore dhe statutare në mënyrë aktive dhe të koordinuar, duke ndërmarrë vendime të rëndësishme për funksionalizimin institucional dhe operacional të OIRK-së. Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-012 dhe Statutit të OIRK-së, Bordi ka luajtur rol kyç në themelimin dhe konsolidimin e strukturave të brendshme, zbatimin e procedurave të licencimit, zhvillimin e mekanizmave të edukimit të vazhdueshëm profesional, si dhe sigurimin e infrastrukturës administrative, teknike dhe financiare të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve publike të Odës.

Vendimet e miratuara gjatë kësaj periudhe reflektojnë përkushtimin e Bordit Drejtues për profesionalizim, standardizim dhe transparencë në të gjitha proceset e punës, si dhe për forcimin e bashkëpunimit institucional brenda sektorit të ndërtimit dhe me partnerë strategjikë. Përmes këtij aktiviteti vendimmarrës, OIRK ka avancuar në konsolidimin e sistemeve të brendshme, rritjen e efikasitetit të shërbimeve ndaj anëtarëve dhe krijimin e bazave të qëndrueshme për zhvillim afatgjatë dhe integrim të plotë në praktikat moderne të administrimit profesional.

Në vijim paraqiten vendimet e miratuara nga Bordi Drejtues gjatë vitit 2025.

Vendimi 01-BD/2025. Bordi ka miratuar formën dhe përmbajtjen e vulës së përkohshme të Odes së Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit dhe ka vendosur që ajo të përdoret deri në përgatitjen e vulës zyrtare.

Vendimi 02-BD/2025. Bordi ka vendosur hapjen e xhirollogarisë zyrtare të Odes dhe ka autorizuar Kryetarin Asim Rapuca që të përfaqësojë Odën në bankat komerciale, të paraqesë kërkesën për hapjen e llogarisë dhe të nënshkruajë dokumentacionin përkatës me të gjitha të drejtat sipas autorizimit të bashkangjitur.

Vendimi 03-BD/2025. Bordi ka autorizuar Kryetarin Asim Rapuca që të përfaqësojë Oden përpara bankave, të nënshkruajë aktet e nevojshme dhe të ndërmarrë veprimet e domosdoshme për hapjen e xhirollogarisë në emër dhe në llogari të Odes së Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit.

Vendimi 04-BD/2025. Bordi ka vendosur shpalljen e konkurseve për: Drejtor Ekzekutiv dhe Zyrtar të Administratës (tri pozita), si dhe ka autorizuar Kryetarin të formojë komisionet e nevojshme për zbatimin e konkursit.

Vendimi 05-BD/2025. Bordi ka autorizuar Kryetarin e Odes të përfaqësojë Oden në të gjitha bankat komerciale pa asnjë kufizim, duke përfshirë hapjen dhe mbylljen e llogarive të Odes, kryerjen e transaksioneve, aplikimin për kartë debit/kredit, aplikimin për e-banking dhe nënshkrimin në emër të Odes për të gjitha produktet kreditore dhe marrëveshjet bankare.

Vendimi 06-BD/2025. Bordi ka themeluar Komisionin Vlerësues për trajtimin e lëndëve të aplikantëve për licensim.

Vendimi 07-BD/2025. Bordi ka anuluar vendimin 06-BD/2025 të datës 06.03.2025 dhe ka ri-themeluar Komisionin Vlerësues dhe Kryesuesin e Komisionit për licensim.

Vendimi 08-BD/2025. Bordi ka themeluar Komisionin Vlerësues dhe Kryesuesin për vlerësimin e kandidatëve aplikues për pozitën Drejtor Ekzekutiv,

Vendimi 09-BD/2025. Bordi ka themeluar Komisionin Vlerësues dhe Kryesuesin e Komisionit për vlerësimin e kandidatëve aplikues për pozitën Zyrtar i Administratës.

Vendimi 10-BD/2025. Bordi ka vendosur shpalljen e konkursit publik për dizajnimin e logos së Odes së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, sipas kriterëve të konkursit.

Vendimi 11-BD/2025. Bordi ka miratuar Programin vjetor të Punës së Odës për vitin 2025.

Vendimi 12-BD/2025. Bordi ka miratuar formularët për rekrutimin e zyrtarëve të administratës dhe të dejtorit ekzekutiv në pajtueshmëri me kërkesat e specifikuara në konkursin publik.

Vendim 13-BD/2025. Bordi ka autorizuar komisionin e ankesave të Odës, si Komision ad-hoc për të trajtuar dhe vendosur mbi të gjitha ankesat që mund të paraqiten në lidhje me procedurat e rekrutimit të stafit

Vendim 14-BD/2025. Bordi ka themeluar Komisionin Vlerësues për vlerësimin e propozimeve të pranuar për llogon zyrtare të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës

Vendim 15-BD/2025. Bordi ka miratuar Procedurën e Ekzekutimit të Buxhetit të Odës për periudhën e përkohshme, në përputhje me kategoritë buxhetore të përcaktuara në Memorandumin e nënshkruar me MMPHI

Vendim 16-BD/2025. Bordi ka miratuar Raportin e Komisionit të Përzgjedhjes për rekrutimin e zyrtarëve të administratës.

Vendim 17-BD/2025. Bordi ka themeluar Komisionin për procedurat e blerjes së mallrave/shërbimeve për nevojat e OIRK-së, me detyra: hartimi i listës së nevojave, përgatitja e kërkesave për oferta, vlerësimi i ofertave sipas kriterëve të transparencës dhe konkurrencës, përgatitja e raportit final.

Vendim 18-BD/2025. Bordi ka vendosur hapjen e aplikimeve për licencë në fushën e ndërtimit duke filluar nga 12.05.2025, sipas procedurave të përcaktuara me rregulloren për Procedurën e Licencimit, Rilicencimit, Mirëmbajtjes, Pezullimit dhe Revokimin e Licencës së Inxhinierit të Licencuar të Odës.

Vendim 19-BD/2025. Bordi ka miratuar raportin e Komisionit të Vlerësimit për ofertat e blerjes së pesë kompjuterëve për nevoja të zyrave të OIRK-së.

Vendim 20-BD/2025. Bordi ka miratuar Raportin e Përzgjedhjes së Logos së Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.

Vendim 21-BD/2025. Bordi miraton raportin e përzgjedhjes së kandidatit për pozitën Drejtor Ekzekutiv të OIRK-së, të hartuar nga Komisioni Vlerësues më 01.04.2025.

Vendim 22-BD/2025. Miratohet shpallja publike për shprehje interesi nga kompanitë e sigurimeve për ofrimin e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për inxhinierët e licencuar të OIRK-së.

Vendim 23-BD/2025. Miratohet forma dhe përmbajtja e vulës protokolare të OIRK-së, e cila përmban emërtimin zyrtar të Odës dhe elementet tjera për protokollimin e dokumenteve.

Vendim 24-BD/2025. Për Formimin e Komisionit për pranimin e mallit pas blerjes së 5 kompjuterëve. Komisioni duhet të konstatoj se pajisjet janë dorëzuar sipas specifikimeve dhe janë funksionale.

Vendim 25-BD/2025. Miratohet formati i licencave A dhe B për inxhinierët e licencuar të OIRK-së dhe vendimit I bashkëngjiten formati i këtyre licencave.

Vendim 26-BD/2025. Bordi vendos për licencimin e profileve të tjera të inxhinierisë që veprojnë në fushën e ndërtimit, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-012 dhe akteve nënligjore të OIRK-së.

Vendim 27-BD/2025. Miratohet Raporti i Vlerësimit të Ofertave për zhvillimin e faqes zyrtare të internetit të OIRK-së (datë 29.05.2025).

Vendim 28-BD/2025. Miratohet programi vjetor i edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP) për anëtarët e licencuar të OIRK-së, duke përfshirë tre trajnimet zyrtare, njëri nga ta planifikohet të mbahet online.

Vendim 29-BD/2025. Miratohet forma dhe përmbajtja e vulës zyrtare të OIRK-së, e cila përmban logon, shkurtesën OIRK dhe emërtimin në shqip, serbisht dhe anglisht.

Vendim 30-BD/2025. Aprovohet lista e dokumenteve të nevojshme për aplikim për Inxhinier Praktikant mbështetur në rreguloren përkatëse të OIRK-së

Vendim 31-BD/2025. Bordi miraton raportin e komisionit të vlerësimit për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme financiarisht për furnizimin e materialeve për inxhinierët e licencuar (licenca, vula, ID, flamuj tavoline, vizitkarta, etj.).

Vendim 32-BD/2025. Miratohet oferta e trajnerit Rinor Hoxha për organizimin e trajnimit me temën “Statuti dhe Rregulloret e Odes”, i cili do të mbahet në katër termine online. Përcaktohen koha, forma e trajnimit dhe pagesa për trajnerin.

Vendim 33-BD/2025. Miratohet kompensimi i pagesës jashtë orarit të punës për stafin administrativ të OIRK-së, me aplikimin e përqindjeve ligjore për punë jashtë orarit sipas ligjit të punës, fundjava dhe festa zyrtare.

Vendim 34-BD/2025. Themelohen komisionet e përkohshme për trajtimin e aplikacionit të licensimit të Bujar Jupaj, duke shmangur konfliktin e interesit. Emërohen anëtarët e komisionit të përkohshëm.

Vendim 35-BD/2025. Bordi merr vendim për zëvendësimin e përkohshëm të anëtarëve të komisionit vlerësues (për shkak të pushimeve vjetore ose mjekësore).

Vendim 36-BD/2025. Bordi ndërmerr vendim për zëvendësimet shtesë të anëtarëve të komisionit të vlerësimit (për arsye të pushimeve vjetore apo mjekësore), duke bërë riorganizimin e përkohshëm të përbërjes së komisionit.

Vendim 37-BD/2025. Miratohet Rregullorja e Punës së Bordit Drejtues të OIRK-së, dokument prej 11 faqesh që përcakton funksionimin, detyrat, përgjegjësitë, mbledhjet, procedurat dhe parimet e punës së Bordit. Gjithashtu Bordi autorizon Kryetarin për realizimin e pagesës Biznesit që ka draftu rreguloren mbështetur në Statut.

Vendimi 38-BD/2025. Bordi miraton Raportin e Përzgjedhjes së Komisionit për Vlerësimin e Ofertave për Sigurimeve e Përgjegjësisë Profesionale të inxhinierëve të licencuar dhe zgjedh kompaninë Scardian si ofertuesin më të favorshëm.

Vendimi 39-BD/2025. Miratohet organizimi i trajnimit të dytë vjetor të EVP me temën “Ligji Ndërtimor – Procedura e Lejes Ndërtimore”. Caktohen terminet, trajnerët, grupet, pagesa për secilin trajner, angazhimin i asistentëve me pagesë ditore, si dhe blerja e materialeve promocionale për trajnim.

Vendimi 40-BD/2025. Miratohet raporti i përzgjedhjes së ofertuesit për hartimin e Rregullores për mënyrën e punës së Kuvendit të Odes si dhe për rishikimin dhe plotësimin e Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm të Administratës së Odës së Inxhinierëve të republikës së Kosovës.

Vendimi 41-BD/2025. Bordi ka vendosur shpalljen e konkursit për një pozitë Zyrtar i Administratës pas dorëheqjes së njërit nga zyrtarët e punësuar, dhe ka përcaktuar kriteret e detajuara të konkurrimit, kërkesat e punës, nivelin e pagës dhe afatin e aplikimit.

Vendimi 42-BD/2025. Bordi ka marrë vendim për ndryshimin e linjave buxhetore, duke transferuar: 40,152.88 € nga paga/meditje, dhe 10,446.00 € nga shpenzimet e udhëtimit, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, për sigurimin dhe funksionalizimin e zyrave të Odes. Kërkesa për ndryshim i dorëzohet Komisionit Mbikqyrës ashtu që ndryshimet të implementohen në MoU.

Vendimi 43-BD/2025. Bordi ka marrë vendim për themelimin e këshillave profesionale / grupet e ekspertëve dhe për ftesë për shprehje interesi, duke përcaktuar kategoritë: Hartimi i EVP, Hartimi i propozimeve për amendamentim të ligjit të odave dhe rregulloreve, Hartimin e propozimeve për amendamentim të Ligjit të Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor, Përmbajtja e dokumentacionit teknik të projekteve.

Vendimi 44-BD/2025. Bordi ka miratuar raportin e përzgjedhjes së ofertës për blerjen e 5 karrigeve të administratës, si dhe raportin e përzgjedhjes së operatorit ekonomik për furnizim me ujë të pijshëm të ambalazhuar për zyrat e OIRK-së

Vendimi 45-BD/2025. Bordi ka themeluar Komisionin Vlerësues për vlerësimin e kandidatëve për pozitën Zyrtar i Administratës (konkursi i datës 23.10.2025).

Vendimi 46-BD/2025. Bordi ka themeluar këshillin profesional / grupin e ekspertëve për hartimin e koncept dokumentit për kostot referente të ndërtimit dhe tarifat referente minimale, mesatare dhe maksimale për shërbimet profesionale të të inxhinierëve.

Vendimi 47-BD/2025. Bordi ka miratuar organizimin e trajnimit të tretë të EVP, me temën: “Mbrotjtja dhe Siguria në Punë në Fushën e Ndërtimit”. Vendimi përfshin: trajnerët, pagesën, blerjen e një baneri 2x3 m, angazhimin i asistentëve me pagesë ditore, kohëzgjatjen e secilit sesion 2 orë.

Vendimi 48-BD/2025. Bordi ka miratuar raportin e përzgjedhjes së kandidatit për pozitën Zyrtar i Administratës, të hartuar nga Komisioni Vlerësues.

Vendimi 49-BD/2025. Bordi ka miratuar raportin e Komisionit të Vlerësimit për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme për marrjen me qira të hapësirës për zyra të OIRK-së, të cilat do të shfrytëzohen nga 1 janari 2026.

4. REALIZIMI I PLANIT VJETOR TË PUNËS (VENDIMI 11-BD-2025)

Plani Vjetor i Punës, i miratuar me vendimin 11-BD-2025, ka shërbyer si dokument themelor zbatues për funksionalizimin dhe konsolidimin e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK), në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012 “Për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit” dhe Statutin e Odes. I strukturuar në 22 pika kryesore, ai përfshin masa normative, institucionale, profesionale dhe administrative që synojnë vendosjen e standardeve të qëndrueshme për licencimin dhe ushtrimin e rregulluar të profesionit të inxhinierit në fushën e ndërtimit, funksionimin efikas të shërbimeve dhe përfaqësimin dinjitoz të profesionit. Zbatimi i këtij plani ka sjellë rezultate të prekshme, duke përfshirë krijimin e infrastrukturës administrative, zhvillimin e mekanizmave të brendshëm organizativë, operacionalizimin e proceseve të licencimit, themelimin e sistemit të edukimit të vazhdueshëm profesional dhe zgjerimin e bashkëpunimeve institucionale brenda dhe jashtë vendit. Të gjitha pikat e Planit Vjetor të Punës janë përmbushur ose janë në fazë të avancuar të implementimit. Në vijim paraqitet realizimi i detajuar i secilës pikë të Planit Vjetor të Punës.

1. Regjistrimi i Odes së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)

OIRK është regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) si subjekt i pavarur juridik, duke përmbushur të gjitha kërkesat ligjore për identifikim fiskal, çka ka mundësuar fillimin e funksionimit administrativ dhe financiar të institucionit.

2. Hapja e llogarisë bankare të OIRK-së

Pas regjistrimit në ATK, është hapur llogaria bankare zyrtare e Odes në njërin nga bankat komerciale të licencuara, duke mundësuar administrimin e financave, pranimin e pagesave të grantit (pagesat e anëtarësisë në periudhën e përkohshme derdhen në llogarinë e mirëbesimit të hapur nga MMPHI) dhe realizimin e transaksioneve të nevojshme për operim.

3. Inventarizimi dhe pajisja e zyrave

Janë identifikuar dhe siguruar të gjitha pajisjet e domosdoshme për funksionim: tavolina pune, karrige, kompjuterë, printer/fotokopje/skaner, tabelë digjitale, telefona fiks, ormana për arkivim, si dhe materialet bazë të punës. Kjo ka mundësuar krijimin e kushteve të plota për punë administrative dhe pritje të aplikantëve.

4. Formimi i komisioneve vlerësuese dhe komisioneve tjera

Janë formuar komisione të shumta sipas kërkesave të Statutit dhe rregulloreve të Odes: komisione vlerësimi, komisione të konkursit, komisione pranimi, grupe ekspertësh dhe komisione ad-hoc. Secili komision është emëruar me vendim të Bordit dhe ka ushtruar mandatin me përgjegjësi.

5. Formimi i administratës dhe zgjedhja e stafit

Administrata e Odes është funksionalizuar duke përzgjedhur Drejtorin Ekzekutiv dhe zyrtarët administrativë përmes procedurave transparente të konkursit publik. Përzgjedhja është bazuar në kritere profesionale, përvojë relevante dhe kompetenca teknike.

6. Krijimi i web-faqes së OIRK-së

Është krijuar dhe publikuar web-faqja zyrtare e Odës, e cila tashmë është tërësisht funksionale dhe përmban informacione rreth licencimit, rregulloreve, anëtarësimit, dokumenteve, regjistrat e anëtarëve, trajnimeve dhe njoftimeve publike. Faqja shërben si kanal kryesor komunikimi me anëtarët dhe publikun.

7. Dizajnimi i logos së Odës

Është dizajnuar dhe miratuar logoja zyrtare e OIRK-së, në përputhje me identitetin institucional dhe standardet grafike. Logoja është integruar në vulat, dokumentet zyrtare, web-faqe dhe materialet promocionale.

8. Trajtimi i aplikacioneve ekzistuese për licencim

Janë pranuar dhe trajtuar të gjitha aplikacionet e bartura nga Ministria e Mjedisit, të cilat përfshinin lëndë të mbetura nga procesi i licencimit. Komisionet përkatëse kanë bërë vlerësimin dhe kanë proceduar lëshimin e licencave sipas kriterëve ligjore.

9. Trajtimi i aplikacioneve të reja për licencim

Pas hapjes së aplikimeve më 12 maj 2025, të gjitha aplikacionet e reja janë pranuar, vlerësuar dhe përpunuar brenda afateve të përcaktuara. Procesi ka përfshirë verifikimin e dokumentacionit, vlerësimin profesional dhe lëshimin e licencave për aplikantët që plotësojnë kriteret.

10. Shënimi i Ditës Botërore të Inxhinierëve – 4 Mars

OIRK ka shënuar Ditën Botërore të Inxhinierëve në ambientet e Fakultetit Teknik, përmes një aktiviteti simbolik që kishte si qëllim promovimin e profesionit dhe prezantimin e hapave të parë të funksionalizimit të Odes.

11. Përgatitja dhe miratimi i programit për edukim të vazhdueshëm profesional (EVP)

Është hartuar dhe miratuar Programi i EVP-së, i cili për vitin 2025 është zbatuar përmes organizimit të tre trajnimeve profesionale. Programi synon ngritjen e vazhdueshme të kompetencave dhe njohurive të anëtarëve të licencuar.

12. Takimet me odat e rajonit dhe mundësitë e bashkëpunimit

Janë zhvilluar takime me Odën e Maqedonisë së Veriut dhe Shoqatën e Inxhinierëve Konsulent të Shqipërisë, duke krijuar bazën për harmonizimin profesional dhe njohjen e ndërsjellë të licencave. Takimi me Odën e Malit të Zi i paraparë është shtyrë për vitin vijues për shkak të procesit zgjedhor atje.

13. Themelimi i grupeve punuese dhe këshillave profesionale

Janë themeluar disa këshilla profesionale dhe grupe ekspertësh, të ngarkuar me hartimin e rregulloreve, EVP-së, analizimin e ligjeve dhe përgatitjen e dokumenteve profesionale. Disa nga këto struktura kanë zhvilluar punë në fund të vitit 2025 dhe disa pritet të angazhohen gjatë vitit 2026.

14. Përfshirja e drejtimve të tjera inxhinierike në OIRK

Është realizuar analiza për zgjerimin e fushëveprimit të licencimit. Përveç ndërtimtarisë, elektroteknikës dhe makinerisë, OIRK tani licencon edhe: Inxhinierët e Gjeoteknikës, Inxhinierët e Gjeologjisë, Inxhinierët e Gjeodezisë, si dhe drejtimet tjera inxhinierike që kontribuojnë në sektorin e ndërtimit.

15. Përfaqësimi i Odës në komisionet për projektligje

OIRK ka caktuar përfaqësuesin e saj në grupin punues për Projektligjin e Ndërtimit. Për projektligjet tjera që pritet të zhvillohen në 2026 (projekt ndryshimi i ligjit për Odën, ligjit për planifikim hapësinor, dhe ligje tjera), përfaqësuesit do të caktohen me kohë.

16. Ndarja e çmimeve dhe mirënjohjeve

Në kuadër të kësaj pike, është marrë vendim që në fillim të vitit 2026 të iniciohet thirrja për aplikim nga anëtarësia, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Bordi Drejtues. Përzgjedhja e fituesve do të realizohet nga një Komision i posaçëm vlerësues, ndërsa çmimet dhe mirënjohjet do të ndahen në kuadër të shënimit të Ditës së Inxhinierit, më 4 mars 2026.

17. Përzgjedhja e kompanisë së sigurimit profesional

Është finalizuar procesi i hapur për përzgjedhjen e kompanisë së sigurimeve për mbulimin e përgjegjësisë profesionale të inxhinierëve të licencuar. Kompania e përzgjedhur ofron mbulueshmëri konform rregullores së miratuar nga Kuvendi i Odës.

18. Mbledhjet e Kuvendit dhe informimi i anëtarëve

Janë bërë thujtje të gjitha përgatitjet për mbajtjen e Kuvendit të Rregullt të OIRK-së, ku do të bëhet konstatimi i kuorumit dhe miratimi i rendit të ditës. Në Kuvend do të prezantohet dhe propozohet për miratim Raporti Vjetor i Punës, njoftohet Kuvendi për Raportin Financiar Vjetor dhe planifikimi për vitin vijues, si dhe do të Raportoj Komisioni Mbikëqyrës. Po ashtu, do të shqyrtohen dhe propozohen për miratim Rregullorja e Punës së Kuvendit të OIRK-së dhe Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të Administratës së OIRK-së, si dhe Rezoluta e Kuvendit lidhur me çmimoren referente në fushën e ndërtimit dhe shërbimeve inxhinierike.

19. Krahassimi i ligjeve me odat e rajonit

Gjatë vitit raportues është bërë analiza krahasuese e legjislacionit të OIRK dhe OARK me ligjet e vendeve të rajonit, me fokus në harmonizimin e rregullimit profesional të inxhinierëve. Me Republikën e Maqedonisë së Veriut, OIRK ka nënshkruar një Memorandum bashkëpunimi, përmes të cilit të dy palët janë pajtuar të punojnë së bashku në harmonizimin e kuadrit ligjor dhe profesional, në përputhje me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian. Sa i përket Republikës së Shqipërisë, aktualisht nuk ekziston një odë e inxhinierëve dhe ligji përkatës është në proces hartimi. OIRK u ka dorëzuar Shoqatës së Inxhinierëve Konsulent të Republikës së Shqipërisë të gjitha dokumentet dhe materialet tona ligjore, në mënyrë që Republika e Shqipërisë ti ketë parasysh këto dokumente ashtu që të shmangen pengesat në njohjen e ndërsjellë të licencave profesionale në të ardhmen.

20. Shqyrtimi i rregullores për njohjen e licencave të jashtme

Rregullorja për licencat e lëshuara jashtë Kosovës është shqyrtuar dhe zbatuar në raste konkrete të aplikantëve që kanë kërkuar konvertim ose njohje të licencës së huaj.

21. Rregullimi i çmimeve të shërbimeve inxhinierike (çmimorja)

Gjatë vitit raportues, grupi punues i përbashkët OIRK–OARK në mbështetje të Bordit Drejtues të dy Odave ka punuar në hartimin e koncept-dokumentit të çmimoreve të ndërtimit dhe çmimoreve të shërbimeve arkitektonike dhe inxhinierike, i cili do të shërbejë si dokument referent për të gjitha projektet dhe shërbimet profesionale në sektorin e ndërtimit.

Për hartimin e dokumentit janë analizuar modelet rajonale dhe evropiane, duke përfshirë:

- Rregulloren e çmimoreve të Maqedonisë së Veriut, e cila është marrë si bazë kryesore, pasi strukturat e kostove dhe çmimet e ndërtimit në dy vendet janë pothuajse të përafërta;
- Rregullorja Kroate, e cila konfirmon përqindjet dhe metodologjitë e përdorura në çmimoret maqedone;
- Rregullorja Gjermane, veçanërisht pjesët që lidhen me tipologjitë e ndërtimeve të ngjashme me rajonin tonë.

Nga analizat është konstatuar se përqindjet e shërbimeve arkitektonike dhe inxhinierike, të cilat derivohen nga vlerat e çmimit të ndërtimit, janë pothuajse të njëjta në Maqedoni, Kroaci dhe Gjermani, duke përforcuar kështu bazueshmërinë profesionale të metodës së përzgjedhur.

Në proces është përdorur si referencë edhe ndarja e kategorive të objekteve sipas Udhëzimit Administrativ të MMPHI-së, përfshirë objektet: ndërtimore, infrastrukture, elektroenergjetike, hidroteknike.

Dokumenti i çmimoreve të ndërtimit dhe çmimoreve të shërbimeve arkitektonike dhe inxhinierike është përpiluar dhe do t'u shpërndahet i plotë anëtarëve për informim dhe konsultim. Dokumenti do të paraqitet në Kuvend në formë të Rezolutës, e cila nuk ka karakter rregullorë dhe nuk krijon detyrime ligjore në këtë fazë, por synon sigurimin e mandatit dhe mbështetjes së anëtarësisë për vazhdimin e procesit të standardizimit të çmimeve referente. Njëkohësisht, dokumenti synon të shërbejë si bazë profesionale orientuese për institucionet publike dhe palët relevante në planifikimin e projekteve dhe vlerësimin e shërbimeve, duke i dhënë mbështetje organeve të Odës

për ta shtyrë përpara këtë iniciativë në koordinim me institucionet relevante, përfshirë edhe proceset e ardhshme të hartimit të legjislacionit në fushën e ndërtimit.

22. Analiza e mundësisë së pavarësimit të plotë (financiar) të OIRK-së

Gjatë vitit raportues është bërë vlerësimi fillestar për mundësinë e pavarësimit financiar të OIRK-së nga MMPHI, duke analizuar kapacitetet administrative, nivelin e të hyrave nga anëtarësia dhe kërkesat ligjore për vetëfinancim. Në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-012, pavarësimi financiar mund të iniciohet nëse organet e Odës e vlerësojnë dhe e dëshmojnë se Oda mund të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme me të hyrat vetanake nga anëtarësia. Megjithatë, gjatë vitit 2025, për shkak të sfidave të funksionalizimit dhe konsolidimit institucional në vitin e parë të punës, nuk ka qenë e mundur të procedohet me këtë proces në mënyrë të plotë. Gjatë vitit 2026 do të realizohet një vlerësim më i detajuar i gjendjes financiare, të hyrave dhe qëndrueshmërisë buxhetore dhe, nëse konstatohet se ekzistojnë kushtet për pavarësim financiar, Bordi Drejtues do të procedojë me paraqitjen e kërkesës përkatëse në Komisionin Mbikëqyrës dhe institucionet relevante, në përputhje me bazën ligjore në fuqi.

5. ANËTARËSIMI, LICENCIMI DHE SIGURIMI PROFESSIONAL

Në zbatim të mandatit ligjor të përcaktuar me Ligjin Nr. 08/L-012 dhe Statutin e OIRK-së, si dhe në mbështetje të rregulloreve të miratuara për licencimin, regjistrimin e praktikantëve dhe sigurimin e përgjegjësisë profesionale, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës ka avancuar dukshëm proceset që rregullojnë ushtrimin e profesionit të inxhinierit në fushën e ndërtimit. Gjatë vitit raportues, OIRK ka vendosur një sistem të strukturuar, transparent dhe funksional për verifikimin e kompetencave profesionale, për formalizimin e procedurave administrative dhe për ofrimin e shërbimeve të reja të domosdoshme për anëtarët e saj.

Proceset e licencimit janë konsoliduar përmes zbatimit të Rregullores për Procedurën e Licencimit, e cila përcakton qartë të drejtën e ushtrimit të profesionit, kriteret e licencimit, mbajtjen e licencës dhe detyrimet profesionale të çdo inxhinieri. Po ashtu, është operacionalizuar edhe sistemi i regjistrimit të praktikantëve, duke formalizuar punën praktike dhe mbikëqyrjen profesionale sipas Rregullores për Praktikantët. Në të njëjtën kohë, është implementuar sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë profesionale, i paraparë me Rregulloren për mënyrën dhe lartësinë e sigurimit, duke rritur nivelin e mbrojtjes ligjore dhe standardet e përgjegjësisë ndaj investorëve dhe palëve të treta.

Një arritje e veçantë e këtij viti ka qenë zgjerimi i fushëveprimit të licencimit, ku pas analizave dhe diskutimeve të gjera, Bordi Drejtues ka miratuar përfshirjen e drejtimeve të reja inxhinierike brenda OIRK-së. Përveç inxhinierëve të ndërtimtarisë, elektroteknikës dhe makinerisë, tani licencohen edhe Inxhinierët e Gjeoteknikës, të Gjeologjisë, të Gjeodezisë dhe drejtimit e tjera që kontribuojnë drejtpërdrejt në sektorin e ndërtimit. Në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-012, nga 1 janari 2026, ushtrimi i profesionit në këto fusha nuk do të jetë i lejuar pa licencë valide të lëshuar nga OIRK.

Po ashtu, këtë vit OIRK ka shënuar një moment historik me fillimin e shpërndarjes së licencave të para profesionale. Për herë të parë që nga themelimi, janë lëshuar licencat e para për inxhinierët që kanë përmbushur kriteret ligjore dhe profesionale, duke dëshmuar konsolidimin praktik të strukturave të Odës dhe funksionalizimin e procesit të licencimit. Ky proces tashmë është i rregullt dhe i pandërprerë, duke garantuar lëshimin e licencave në kohë dhe trajtimin profesional të të gjithë aplikantëve.

Këto zhvillime përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një ekosistemi të rregulluar profesional të mbështetur në standarde të qarta etike, teknike dhe procedurale. OIRK, përmes këtyre proceseve, ka vendosur themelet për një sistem modern, efikas dhe të besueshëm, duke e forcuar integritetin dhe cilësinë e shërbimeve inxhinierike në Republikën e Kosovës.


Në vijim paraqiten rezultatet kryesore të arritura në fushën e anëtarësimit, licencimit, praktikës profesionale, sigurimit të përgjegjësisë profesionale dhe zgjerimit të fushëveprimeve të licencimit.

5.1 Anëtarët e licencuar

Janë anëtarësuar dhe licencuar rreth **1082 inxhinierë të rinj** në fushën e ndërtimtarisë, elektroteknikës dhe makinerisë.

Fusha Inxhinierike	Numri i anëtarëve
Inxhinieri Ndërtimore	506
Inxhinieri Elektroteknike	298
Inxhinieri Mekanike	249
Inxhinieri Gjeodezisë	13
Inxhinieri Gjeologjisë	3
Totali	1,082

Struktura e antarëve të licencuar sipas fushës



- Më poshtë janë paraqitur numri i drejtimeve sipas licencës së marr.

a) Inxhinieri Ndërtimore – gjithsej 506 inxhinierë

294 – Drejtimi Konstruktiv

128 – Drejtimi Hidroteknik

46 – Drejtimi Infrastrukturë Rrugore

20 – Drejtimi i Përgjithshëm

3 – Drejtimi Menaxhimi dhe Teknologjia e Ndërtimit

13 – Inxhinieri e Ambientit

2 – Drejtimi Gjeoteknik

b) Inxhinieri e Gjeodezisë – gjithsej 13 inxhinierë

c) Inxhinieri e Gjeologjisë – gjithsej 3 inxhinierë

d) Inxhinieri Elektroteknike – gjithsej 298 inxhinierë:

7 - Automatikë

4 - Automatikë me Elektronikë

4 - Baçelor i Shkencave në Inxhinieri e Energjisë

26 - Elektroenergjetikë Industriale

3 - Elektroenergjetikë në Prodhimtari

35 - Elektronikë

2 - Elektroteknikë

148 - Energjetikë

20 - Energjia Elektrike dhe Tregjet e Energjisë

1 - Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment

1 - Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment, me specializim Eficenca e Energjisë

1 - Inxhinieria Elektrike

15 - Kompjuterikë me Telekomunikacion

1 - Master i Shkencave në Transport të qëndrueshëm dhe Sistemet e Energjisë Elektrike

1 - Master i Shkencës në Elektronikë dhe Inxhinieri Kompjuterike

2 - Menaxhim i Mekatronikës

5 - Shkenca Kompjuterike

3 - Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri

1 - Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri me specializim Shkenca e të Dhënave Statistikore

1 - Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi

17 - Telekomunikacion

e) Inxhinieri Mekanike – gjithsej 249 inxhinierë (licencuar në drejtime të ndryshme brenda fushës së makinerisë)

13 - Energji e ripërtitshme

74 - Komunikacion

28 - Konstruksion

4 - Makineri

2 - Mekatronikë

59 – Prodhimtari

69 - Termoenergjetikë dhe termoteknikë

Është krijuar dhe mirëmbajtur **Regjistri i Inxhinierëve të Licencuar**, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 08/L-012.

5.2 Regjistrimi i praktikantëve

- Ka filluar **regjistrimi i praktikantëve**, si hap i parë drejt sistemimit të praktikës profesionale mbështetur në rregulloren përkatëse. Deri më tani janë regjistruar 7 praktikantë Master dhe 4 Bachelor.
- Janë përgatitur procedurat bazë dhe formatet për regjistrim, në përputhje me Statutin dhe rregulloret e brendshme.

5.3 Sigurimi i përgjegjësisë profesionale

- Ka nisur **implementimi i sigurimit të përgjegjësisë profesionale** për inxhinierët të licencuar, në përputhje me rregulloren e OIRK-së.
- Është zhvilluar procesi i thirrjes së interesit nga të gjitha kompanitë e licencuara të sigurimeve në BQK, nga ky process është zgjedhur oferta më e mire për anëtarësinë.

5.4 Zgjerimi i fushëveprimit të licencimit

Pas një procesi të gjatë analizash dhe diskutimesh, Bordi Drejtues i OIRK-së ka miratuar vendimin për **përfshirjen dhe licencimin e drejtimeve të reja inxhinierike** brenda Odës, në pajtim të plotë me Ligjin Nr. 08/L-012 dhe Statutin e OIRK-së.

Përveç inxhinierëve të ndërtimtarisë, elektroteknikës dhe makinerisë, tani në OIRK mund të anëtarësohen dhe licencohen edhe: Inxhinierët e Gjeoteknikës, Inxhinierët e Gjeologjisë, Inxhinierët e Gjeodezisë, si dhe drejtime të tjera inxhinierike që kontribuojnë drejtpërdrejt në sektorin e ndërtimit.

Nga **1 janari 2026**, ushtrimi i profesionit në këto fusha nuk do të jetë i lejuar pa licencë të vlefshme të lëshuar nga OIRK. Kryetari i Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës është njoftuar e gjithashtu është bërë njoftimi publik për vendimin e Bordit Drejtues lidhur me përfshirjen edhe të këtyre drejtimeve inxhinierike në OIRK në pajtim me ligjin.

5.5 Fillimi i shpërndarjes së licencave të para profesionale

Gjatë vitit raportues, OIRK ka nisur **shpërndarjen e licencave të para profesionale**, duke shënuar një moment historik në konsolidimin e institucionit dhe zbatimin praktik të rregullimit të profesionit.

- Për herë të parë pas themelimit, OIRK ka arritur të konsolidojë strukturat e saj dhe të nisë me sukses procesin e licencimit të anëtarëve.
- Licencat e para janë shpërndarë personalisht nga Kryetari i OIRK-së, i cili ka uruar kolegët për këtë arritje të përbashkët.
- Procesi i licencimit tashmë është i strukturuar dhe do të vazhdojë pa ndërprerje, me përpunim dhe shpërndarje të licencave në kohë sa më të shkurtër për të gjithë aplikuesit që përmbushin kushtet.
- Nënvizohet se e drejta për ushtrimin e profesionit të inxhinierit në Republikën e Kosovës u takon vetëm atyre që janë anëtarë të Odës dhe posedojnë licencë valide, sipas rregulloreve në fuqi.

6. DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE – PLATFORMA ELICENCA

Digjitalizimi i proceseve dhe shërbimeve të OIRK-së përfaqëson një komponent thelbësor të modernizimit administrativ dhe të përmbushjes së mandatit ligjor për rregullimin dhe standardizimin e ushtrimit të profesionit të inxhinierit në Republikën e Kosovës. Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012 dhe Statutin e Odës, i cili kërkon funksionim efikas, transparent dhe të qashtë për anëtarët, OIRK ka qenë pjesë aktive e projektit shumëpalësh për zhvillimin e platformës elektronike eLicenca.

Kjo platformë digjitale është konceptuar për të integruar në një sistem të unifikuar të gjitha shërbimet kryesore institucionale – nga licencimi dhe rilicencimi, te EVP-ja, regjistrimi i praktikantëve, sigurimi profesional dhe administrimi i regjistrave – duke zvogëluar procedurat manuale, rritur efikasitetin operativ dhe përmirësuar ndjeshëm qasjen e anëtarëve në shërbimet e Odës. Përmes këtij transformimi, OIRK synon krijimin e një ekosistemi modern, të automatizuar dhe profesional të shërbimeve të rregulluara.

Gjatë vitit raportues, përfaqësuesit e OIRK-së kanë kontribuar në mënyrë substanciale në të gjitha fazat e projektit – nga dizajnimi i arkitekturës së sistemit, harmonizimi me kërkesat profesionale të OIRK dhe OARK, testimet teknike dhe punëtoritë funksionale, deri te prezantimet përfundimtare para partnerëve institucionalë. Kontributet profesionale të OIRK-së kanë siguruar që funksionalitetet e platformës të reflektojnë me saktësi nevojat reale të procesit të licencimit, verifikimit dhe administrimit të të dhënave të anëtarëve.

Sipas njoftimeve nga MMPHI, platforma pritet të lansohet dhe të hyjë në përdorim gjatë vitit 2026.

Në vijim paraqiten aktivitetet kryesore të realizuara në kuadër të këtij procesi.

6.1 Takimet dhe Punëtoritë për platformën eLicenca

OIRK, përkatësisht përfaqësuesit e saj, në bashkëpunim me OARK, MMPHI, Zyrën e Kryeministrit dhe kompaninë “Kutia”, ka marrë pjesë në një numër takimesh pune si dhe në punëtorinë dyditore në Hotel Sharri – Prevallë, kushtuar punimit të softwerit për digjitalizimin e shërbimeve si dhe prezantimit dhe testimit praktik të platformës elektronike **eLicenca**, projekt ky i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Gjermane, i zbatuar nga GIZ dhe MMPHI.

Platforma synon të përfshijë të gjitha shërbimet kryesore të Odave, duke mundësuar:

- aplikimin online për licencim dhe rilicencim;
- menaxhimin elektronik të taksave dhe tarifave;
- aplikimin dhe evidentimin e EVP-së;
- regjistrimin dhe administrimin e praktikantëve;
- njohjen e licencave të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës;
- administrimin e sigurimit të përgjegjësisë profesionale;
- mbajtjen e regjistrave elektronikë dhe procedurave disiplinore, etj.

Gjatë punëtorisë, stafi administrativ i Odave testoi skenarë realë aplikimi dhe licencimi, dha vërejtje dhe sugjerime për përmirësim dhe kontribuoi në finalizimin e funksionaliteteve të sistemit.

6.2 Prezentimi përfundimtar në GIZ

Në ambientet e GIZ-it në Prishtinë është mbajtur prezentimi përfundimtar i platformës online për e-licencim, para përfaqësuesve të OIRK, OARK dhe MMPHI-së.

Ku janë prezantuan mundësitë për:


- aplikim online për licencat A dhe B;
- ngarkim elektronik të dokumenteve;
- gjurmim të statusit të aplikimit në kohë reale;
- menaxhim të pagesave dhe anëtarësisë vjetore;
- komunikim zyrtar elektronik me Odat, etj.

Platforma aktualisht është në fazën testuese dhe pritet shumë shpejt të lansohet përmes eKosova.

7. EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (EVP)

Viti 2025 ka shënuar fillimin e zbatimit praktik të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP) në OIRK, një detyrim ligjor i përcaktuar me Ligjin Nr. 08/L-012 dhe i rregulluar përmes Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional të Inxhinierëve të Licencuar.

Trajnimi	Data	Pjesëmarrës	Pikë EVP
Statuti dhe Rregulloret e OIRK	28.06 – 01.07.2025	804	2
Ligji i Ndërtimit dhe Leja Ndërtimore	04 & 11.10.2025	1197	3
Mbrojtja dhe Siguria në Punë	15 & 22.11.2025	939	3



Ky vit ka qenë themelor për krijimin e mekanizmave të parë funksionale të EVP-së, duke pasur parasysh se administrata e Odës ka filluar punën në muajin maj dhe grantet qeveritare janë ekzekutuar vetëm në prill.

Pavarësisht sfidave të qarta organizative, teknike dhe kohore, OIRK ka arritur të realizojë me sukses tre trajnime bazë, duke siguruar përmbushjen e minimumit prej 8 pikëve kredituese të kërkuara nga rregullorja. Trajnimi i parë u zhvillua online, si përvojë e re për Odën dhe anëtarët, duke testuar kapacitetet digjitale dhe komunikimin interaktiv në distancë. Dy trajnimet tjera u organizuan fizikisht në institucione të ndryshme akademike, duke sjellë sfida logjistike, por edhe mundësi të vlefshme për të kuptuar kërkesat reale operationale të EVP-së.

Këto përvoja të para – si në formatin online ashtu edhe në atë fizik – kanë shërbyer si model i rëndësishëm testues për standardizimin e procesit, planifikimin e ngarkesave, përmirësimin e koordinimit administrativ dhe përcaktimin e praktikave më të mira për organizimin e aktiviteteve

të ardhshme. Pjesëmarrja e gjerë e anëtarëve dhe angazhimi i trajnerëve kanë kontribuar në krijimin e bazës së qëndrueshme për zhvillimin e EVP-së në vitet në vijim.

Në vijim paraqiten të gjitha trajnimet e realizuara gjatë vitit raportues, përmbajtja profesionale dhe vlerësimi i arritur.

7.1 Trajnimi i parë – Statuti dhe Rregulloret e OIRK

- Tema: “Statuti dhe Rregulloret e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës”
- Forma: online
- Trajner: Rinor Hoxha
- U organizua në katër termine të veçanta (**28 qershor – 1 korrik 2025**), për të mundësuar pjesëmarrje sa më të gjerë.

Pjesëmarrja: **804 anëtarë të OIRK-së**

Sipas vendimit përkatës të Bordit Drejtues, ky trajnim vlerësohet me **2 pikë EVP** për secilin pjesëmarrës.

Qëllimi i trajnimit ishte informimi i anëtarëve me përmbajtjen e Statutit, strukturën e organeve, rregulloret e miratuara dhe detyrimet që rrjedhin nga licencimi. Pjesëmarrja ka qenë e madhe dhe trajnimet janë karakterizuar nga diskutime të hapura dhe pyetje praktike nga anëtarët.

7.2 Trajnimi i dytë – Ligji i Ndërtimit dhe procedurat e lejes ndërtimore

Trajnimi i dytë i EVP-së, me temën “Ligji i Ndërtimit – Procedurat e Lejes Ndërtimore”, është zhvilluar në dy data dhe në dy institucione:

- **4 tetor 2025** – Fakulteti Teknik, Universiteti i Prishtinës (grupet 1, 2, 3 dhe 4), me trajnerë Ilir Rodiqi dhe Enver Bytyqi.
- **11 tetor 2025** – Kampusi i Kolegjit UBT në Lipjan (grupet 5, 6, 7 dhe 8), me trajnerë Esat Gashi dhe Ramë Hamza.
- Pjesëmarrja: **1197 anëtarë të OIRK-së**

Fokusi i trajnimit ka qenë:

- kuadri ligjor i ndërtimit;
- procedurat e lejes ndërtimore dhe dokumentacioni teknik;
- roli dhe përgjegjësitë profesionale të inxhinierëve të licencuar në këto procese.

Sipas vendimit përkatës të Bordit Drejtues, ky trajnim vlerësohet me **3 pikë EVP** për secilin pjesëmarrës.

7.3 Trajnimi i tretë – Shëndeti dhe siguria në punë në ndërtim

- Tema: “Mbrotjtja dhe Siguria në Punë në Fushën e Ndërtimit”

- Datat: 15 dhe 22 nëntor 2025
- Trajnerë: Burim Islami, Ruzhdi Feka dhe Miftar Mehanjaj
- Pjesëmarrja: **939 anëtarë të OIRK-së**

Trajnimi ka trajtuar:

- detyrimet ligjore dhe teknike për sigurinë në punë;
- vlerësimin e rrezikut dhe masat mbrojtëse në kantier;
- përgjegjësinë profesionale të inxhinierëve në raport me sigurinë publike.

Sipas vendimit përkatës të Bordit Drejtues, ky trajnim vlerësohet me **3 pikë EVP** për secilin pjesëmarrës.

7.4 Vlerësim dhe planifikim për EVP

- Në vitin 2025 janë realizuar **8 pikë EVP**, minimumi i kërkuar nga rregullorja.
- Për shkak të buxhetit të kufizuar dhe nisjes së vonshme të proceseve, nuk ka qenë e mundur të realizohen të gjitha 20 pikët e planifikuara.
- Për vitin 2026 planifikohet miratimi i një **Plani të plotë EVP**, që do të mbulojë të gjitha drejtimet profesionale brenda OIRK-së dhe do të realizohet me kushte më të mira organizative.

8. RREGULLORET DHE AKTET E BRENDSHME

Në mbështetje të kompetencave të përcaktuara në Kapitullin VI të Statutit të Odës, veçanërisht Nenit 31, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës ka obligim të hartojë dhe miratojë aktet e përgjithshme që rregullojnë funksionimin e saj, përfshirë rregulloret, procedurat dhe mekanizmat e brendshëm institucionalë. Këto akte sigurojnë ligjshmëri, transparencë dhe standarde të qarta profesionale në ushtrimin e kompetencave të organeve të OIRK-së, si dhe krijojnë bazën normative për licencim, disiplinë profesionale, administrim dhe funksionim të Kuvendit e Bordit Drejtues.

Gjatë vitit raportues, në përputhje me detyrimet statutare, OIRK ka avancuar në mënyrë substanciale procesin e hartimit të rregulloreve themelore dhe akteve të brendshme, duke krijuar kornizën fillestare normative mbi të cilën do të ndërtohet funksionimi i qëndrueshëm i institucionit. Këto rregullore janë hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012, kanë kaluar në procedurat e parapara të shqyrtimit dhe pëlqimit nga organet përkatëse dhe përbëjnë bazën për zhvillimin e akteve të tjera që priten të finalizohen gjatë vitit 2026.

Në vijim paraqiten rregulloret dhe aktet kryesore të punuara dhe miratuara gjatë vitit raportues.

- Është hartuar dhe miratuar **Rregullorja e Punës së Bordit Drejtues**, e cila rregullon procedurat e mbledhjeve, vendimmarrjes dhe përgjegjësi të anëtarëve.
- Është hartuar **Rregullorja e Punës së Kuvendit**, e cila paraqitet në Kuvend për miratim.
- Është hartuar **Rregullorja e Punës së Administratës**, që përcakton strukturën, detyrat dhe procedurat operative të administratës, e cila paraqitet në Kuvend për miratim.

9. MEMORANDUMET E MIRËKUPTIMIT DHE BASHKËPUNIT

Në përputhje me mandatin ligjor dhe statutor të OIRK-së për të përfaqësuar, harmonizuar dhe avancuar interesat e profesionit të inxhinierit në Republikën e Kosovës, bashkëpunimi institucional përbën një dimension thelbësor të funksionimit të Odës. Statuti i OIRK-së e përcakton qartë se Oda ka të drejtë dhe obligim të zhvillojë partneritete me institucionet shtetërore, institucionet akademike, organizatat profesionale vendore e ndërkombëtare, komunat, sektorin privat dhe palë të tjera të rëndësishme, me qëllim ngritjen e standardeve profesionale, përmirësimin e legjislacionit në fushën e ndërtimit dhe forcimin e kapaciteteve të profesionit të inxhinierit.

Gjatë vitit raportues, OIRK ka qenë aktive në zgjerimin e këtij rrjeti bashkëpunimi, duke nënshkruar 13 Memorandume Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi, të cilat shërbejnë si instrumente strategjike për zbatimin e detyrave statutare, përfshirë:

- mbështetjen profesionale të anëtarëve;
- kontributin në zhvillimin dhe harmonizimin e politikave publike në ndërtim;
- avancimin e edukimit të vazhdueshëm profesional;
- krijimin e platformave të përbashkëta shkencore, akademike dhe profesionale;
- bashkëpunimin ndër-institucional në rrafsh vendor dhe ndërkombëtar;
- forcimin e rolit të inxhinierëve të licencuar në projektet publike të fushës së ndërtimit;
- dhe promovimin e standardeve të integritetit dhe transparencës në sektorin e ndërtimit.

Këto marrëveshje përbëjnë një mekanizëm të rëndësishëm për forcimin e pozitës së OIRK-së si aktor kyç në ekosistemin e ndërtimit dhe për krijimin e një hapësire bashkëpunuese mes profesionistëve, institucioneve dhe industrisë. Përmes tyre, OIRK afirmon rolin e vet si autoritet publik dhe qendër referuese profesionale, duke kontribuar drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së shërbimeve inxhinierike dhe në përmirësimin e qeverisjes teknike dhe profesionale në vend.

Në vijim paraqitet një përmbledhje e memorandumëve të nënshkruar dhe fushëveprimi kryesor i secilit.

1. **MMPHI – OIRK**, Kuadër bashkëpunimi për funksionalizimin e OIRK-së, mbështetjen financiare dhe logjistike, si dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e ndërtimit.
2. **OIRK - Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore UP**, Bashkëpunim akademik dhe profesional për ngritjen e cilësisë së arsimit, EVP, mbështetje logjistike, projekte të përbashkëta, përfshirjen e studentëve në aktivitetet e OIRK-së, etj.
3. **OIRK - Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore UBT**, Partneritet për zhvillimin e programeve studimore, EVP, projekte kërkimore, mbështetje logjistike, praktika profesionale për studentët, etj.

4. **OIRK - Komuna e Pejës**, Bashkëpunim për këshillim teknik, trajnime, përfshirje të inxhinierëve të licencuar në projektet komunale, harmonizim me legjislacionin e ndërtimit, etj.
5. **OIRK - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (Universiteti Isa Boletini)**, Bashkëpunim për EVP, projekte shkencore, praktika, mbështetje ligjistike, përfshirje të studentëve në OIRK, etj.
6. **OIRK - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike UP**, Partneritet për aktivitete akademike të përbashkëta, EVP, zhvillim të kurikulave, mbështetje logjistike, projekte kërkimore-shkencore, etj.
7. **OIRK - TITAN Sharrcem**, Kuadër bashkëpunimi për praktika profesionale, EVP, shkëmbim të njohurive teknike, pjesëmarrje në politikat publike, promovim të standardeve profesionale, etj.
8. **OIRK - Kolegji UBT, Fakulteti i Inxhinierisë së Energjisë**, Marrëveshje për EVP, projekte të përbashkëta, rishikim programesh studimore, përfshirje të studentëve në aktivitetet profesionale të OIRK-së, etj.
9. **OIRK - Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP)**, Bashkëpunim për eliminimin e kriterëve diskriminues në tenderë, përfshirjen e qartë të licencimit nga OIRK si kriter ligjor dhe promovimin e transparencës në prokurimin publik në ndërtim.
10. **OIRK - Oda e Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar të Maqedonisë së Veriut (OAAI/OAIC)**, Marrëveshje për bashkëpunim të ndërsjellë, shkëmbim përvojash, harmonizim të standardeve profesionale dhe zhvillim të përbashkët të dokumenteve rregullative.
11. **Marrëveshje Bashkëpunimi OIRK – SCARDIAN SH.A**, OIRK ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me kompaninë SCARDIAN SH.A për ofrimin e sigurimit të përgjegjësisë profesionale në mbështetje të rregullores për të gjithë inxhinierët e licencuar të Odës. Marrëveshja rregullon procedurat e aplikimit, përgatitjen individuale të policave për secilin anëtar dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse. Sigurimi mbulon gabimet në projektim, përjashtime apo lëshime në dokumentacion teknik, neglizhencë profesionale gjatë mbikëqyrjes apo zbatimit të punimeve, shkelje të standardeve teknike që sjellin pasoja financiare apo dëme për palët e treat, etj. Marrëveshja është e vlefshme për periudhën.
12. **OIRK - Oda Ekonomike e Kosovës / Shoqata e Prokurimit të Bizneseve të Kosovës (OEK & ShPBK)**, Kuadër bashkëpunimi për zbatimin e ligjit në prokurim publik, eliminimin e kriterëve diskriminues, rritjen e cilësisë së ofertave dhe krijimin e një platforme të përbashkët lobimi profesional.
13. **OIRK – Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)**, Marrëveshje bashkëpunimi për forcimin e ligjshmërisë dhe transparencës në fushën e ndërtimit, verifikimin e licencimit profesional të inxhinierëve, parandalimin e ushtrimit të profesionit pa licencë, si dhe rritjen e përgjegjësisë profesionale në projektet publike të fushës së ndërtimit (projektim, mbikëqyrje, inspektim dhe pranim teknik).

10. KOMISIONET DHE TRAJTIMI I LËNDËVE

Në kuadër të funksionimit institucional të OIRK-së, komisionet e pavarura përbëjnë mekanizma të domosdoshëm për garantimin e drejtësisë procedurale, respektimit të standardeve profesionale dhe ruajtjen e integritetit të profesionit të inxhinierit. Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012, Statutin e OIRK-së dhe rregulloret përkatëse, këto komisione kanë mandat të qartë për trajtimin e lëndëve disiplinore dhe shqyrtimin e ankesave në shkallë të dytë, si pjesë e sistemit të llogaridhënies profesionale brenda Odës.

Kodi i Etikës dhe i Sjelljes Profesionale përcakton parimet dhe standardet që duhet të udhëheqin punën e çdo anëtari të OIRK-së, ndërsa shkelja e tyre rezulton në iniciimin e procedurave disiplinore, të cilat zhvillohen sipas rregullores së miratuar nga Oda. Komisioni Disiplinor është përgjegjës për shqyrtimin e rasteve dhe shqiptimin e masave, ndërsa Komisioni i Ankesave garanton të drejtën për rishqyrtim dhe merr vendime përfundimtare brenda sistemit të OIRK-së.

Gjatë vitit raportues, këto komisione kanë ushtruar mandatin e tyre përmes trajtimit të lëndëve konkrete, marrjes së vendimeve të argumentuara profesionalisht dhe bashkëpunimit të ngushtë me organet e tjera të OIRK-së. Takimet koordinuese të organizuara me Bordin Drejtues kanë kontribuar në harmonizimin e qasjeve rreth Kodit të Etikës, forcimin e integritetit dhe zhvillimin e një kulture institucionale të përgjegjësisë dhe profesionalizmit.

Në vijim paraqiten aktivitetet dhe rezultatet kryesore të punës së këtyre komisioneve gjatë vitit raportues.

10.1 Komisioni i Ankesave

Komisioni i Ankesave ka trajtuar **3 lëndë** gjatë vitit, duke dhënë vendime përfundimtare në përputhje me Ligjin, Statutin dhe rregulloret përkatëse. Proceset janë zhvilluar duke respektuar:

- të drejtën për ankesë;
- parimin e paanshmërisë;
- transparencën dhe arsyetimin profesional të vendimeve.

10.2 Komisioni Disiplinor

Si institucion i ri, Organet e OIRK-së e kanë pa të arsyeshme që në këtë fillim të funksionimit të organizoj taimë të përbashkëta edhe me Komisionet e pavarura të OIRK-së, në funksion të kësaj Bordi drejtues ka organizuar takime të përbashkëta me Komisionin Disiplinor dhe Komisionin e Ankesave për koordinim rreth **Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale**, duke theksuar:

- domosdoshmërinë e veprimit me integritet dhe profesionalizëm;
- ndalimin e sjelljeve që cenojnë reputacionin e profesionit;
- shmangien e konfliktit të interesit dhe veprimeve mashtruese.

11. TAKIMET DHE AKTIVITETET KRYESORE GJATË VITIT

Në përputhje me kompetencat statutare të OIRK-së për përfaqësimin e profesionit, bashkëpunimin institucional, hartimin e akteve dhe mbikëqyrjen e standardeve profesionale, gjatë vitit raportues janë zhvilluar një sërë takimesh dhe aktiviteteve që kanë pasur rol vendimtar në funksionalizimin dhe konsolidimin e Odës. Këto takime kanë përfshirë bashkëpunimin me institucionet qendrore, komunat, agjencitë rregullative, odat profesionale brenda dhe jashtë vendit, sektorin privat, si dhe organizatat ndërkombëtare.

Në fazën e parë të themelimit dhe operimit të OIRK-së, këto angazhime kanë qenë thelbësore për:

- ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe administrative;
- vendosjen e mekanizmave të licencimit, EVP-së dhe regjistrave profesionalë;
- harmonizimin me institucionet shtetërore në zbatimin e legjislacionit të ndërtimit;
- avancimin e standardeve profesionale dhe etike të inxhinierëve;
- krijimin e partneriteteve strategjike për zhvillim të mëtejshëm.

Takimet kanë shërbyer gjithashtu për prezantimin e mandatit dhe rolit të Odës sipas Statutit, përfaqësimin e interesave të anëtarëve, si dhe për sigurimin e një qasjeje të koordinuar ndër-institucionale në çështjet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sektorin e ndërtimit.

Ato kanë kontribuar dukshëm në ndërtimin e kulturës së re profesionale që synon transparencë, llogaridhënie dhe profesionalizëm të lartë në shërbim të interesit publik.

Në vijim paraqiten takimet dhe aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë vitit, të strukturuar sipas fushave përkatëse të bashkëpunimit.

11.1 Takime për funksionalizimin e OIRK dhe licencimin

- **Takimi me Ministrin e MMPHI-së (04.02.2025)** – koordinimi për funksionalizimin e Odës, hapjen e konkursit për administratën, marrjen e numrit fiskal, vulës, hapjen e llogarisë bankare dhe vazhdimin e licencimit në bashkëpunim me Komisionin Ministror.
- **Takimet e përbashkëta të bordeve OIRK & OARK** – janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm takimesh koordinuese ndërmjet dy Bordëve Drejtues, me fokus funksionalizimin e plotë të odave dhe avancimin e standardeve në sektorin e ndërtimit, harmonizimin e plotë të procedurave të licencimit, koordinimi për fillimin e pranimin të aplikimeve për licenca të reja, planifikimi i EVP-së, njoftimet për KRPP, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare mbi detyrimin për licencim nga OIRK dhe OARK, si dhe bashkëpunimin intensiv për hartimin e çmimoreve të ndërtimit dhe çmimoreve të shërbimeve arkitektonike dhe inxhinierike.
- **Takime koordinuese me organet e Odës (Komisioni Disiplinor dhe Komisioni i Ankesave)** – gjatë vitit janë realizuar takime koordinuese me këto organe me qëllim të konsolidimit dhe funksionalizimit sa më të mirë të tyre, harmonizimit të procedurave të brendshme dhe përgatitjes për trajtimin e çështjeve disiplinore dhe ankesave në përputhje me kornizën ligjore dhe aktet e Odës.

- **Njoftimi zyrtar për hapjen e aplikimeve për licencë (12 maj 2025)** – shpallja e fillimit të pranimit të aplikimeve për licencim profesional, me dokumentacionin e plotë dhe procedurat përkatëse.
- **Takimi me Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP)** – koordinimi për përfshirjen e detyrueshme të licencimit nga OIRK në dokumentet standarde të tenderimit, eliminimin e kërkesave jologjore dhe mbështetjen për konkurrencë të ndershme.
- **Takimi me Shoqatën e Bizneseve për Prokurim Publik** – diskutim mbi kriteret diskriminuese në tenderë, nevojën për standarde të qarta dhe hapat drejt një memorandumit për praktikë më transparente në prokurimin publik.
- **Takimi me KOSTT SH.A.** – prezantimi i detyrimeve ligjore për licencimin e inxhinierëve, verifikimin e licencave dhe integrimin e EVP-së si kusht për ushtrimin e profesionit në projektet energjetike.

11.2 Takime me institucione shtetërore dhe rregullatore

- **Takime me fakultetet e inxhinierisë të akredituara në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunimi akademik** – gjatë vitit janë zhvilluar takime me fakultetet e inxhinierisë të akredituara në Republikën e Kosovës për koordinim në tema të edukimit, zhvillimit profesional dhe lidhjes së praktikës me akademinë. Po ashtu, janë iniciuar dhe finalizuar marrëveshje bashkëpunimi përmes memorandumeve, me qëllim mbështetjen e studentëve dhe të sapodiplomuarve, organizimin e praktikave dhe trajnimeve profesionale, si dhe përfshirjen e ekspertëve në avancimin e standardeve profesionale në fushën e ndërtimit.
- **Takimi me Kolegjin për Planifikim Hapësinor (20 maj 2025)** – prezantimi i mandatit të OIRK-së para komunave dhe partnerëve institucionalë, roli i regjistrave të inxhinierëve të licencuar dhe mbështetja teknike për komunat.
- **Takimi me Kryetarin e Komunës së Pejës** – u zhvillua takim pune dhe u nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi për fuqizimin e standardeve profesionale dhe zbatimin e ligjit në nivel lokal, me fokus në angazhimin e inxhinierëve të licencuar në projektet komunale, mbështetjen për EVP dhe refuzimin e projekteve të realizuara nga persona pa licencë.
- **Takimi me Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP)** – takim zyrtar ndërmjet Bordit të OIRK-së dhe Bordit të KRPP-së për koordinim institucional në zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-012 dhe përmirësimin e praktikave të prokurimit publik në fushën e ndërtimit; u theksua obligueshmëria e licencimit nga OIRK pas 30 majit 2025, nevoja që licenca e vlefshme të përfshihet si kriter i detyrueshëm në dosjet e tenderëve dhe verifikimi i saj përmes bazës elektronike të OIRK-së, si dhe eliminimi i kërkesave/dokumenteve të padrejta apo jologjike që cenojnë konkurrencën dhe integritetin profesional.
- **Takimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK)** – diskutimi mbi licencimin e inxhinierëve në raport me proceset kadastrale, mundësinë e integritetit të inxhinierëve të gjeodezisë në OIRK dhe qartësimin e rolit të tyre profesional.
- **Takimi me Odën Ekonomike të Kosovës (OEK)** – u zhvillua takim pune dhe u nënshkrua memorandum bashkëpunimi për koordinim në përmirësimin e praktikave të prokurimit publik në ndërtim, eliminimin e kriterëve diskriminues në tenderë dhe fuqizimin e rolit të inxhinierëve të licencuar në projektet publike.
- **Takimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA)** – prezantimi i rëndësisë së përfshirjes së inxhinierëve dhe arkitektëve të licencuar në të gjitha fazat e projekteve publike dhe reflektimi i kësaj në proceset e auditimit publik.

11.3 Takime me odat dhe shoqatat profesionale

- **Takimi në Shkup me Odën e Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë (OAAI)** – shkëmbim përvojash për licencimin dhe bazë për memorandumit e bashkëpunimit dhe njohjen e ndërsjellë të licencave.
- **Takimi me Odën e Farmacistëve të Kosovës** – shkëmbim përvojash mbi rregulloret financiare, proceset e rekrutimit, EVP-në dhe mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të Kuvendit, si shembull praktik i një ode të konsoliduar.
- **Takimi me Shoqatën Shqiptare të Inxhinierëve Konsulent (SHOSHIK), Tiranë** – takim dyditor për harmonizimin ligjor, njohjen e ndërsjellë të licencave dhe krijimin e një hapësire profesionale të përbashkët shqiptare në fushën e ndërtimit.
- **Takimi me Shoqatën “Albanian Engineering of Switzerland”** – vendosja e themeleve për bashkëpunim me diasporën profesionale shqiptare, krijimin e një grupi të përbashkët pune dhe përgatitjen e një Memorandumi Mirëkuptimi.

11.4 Takime me përfaqësi diplomatike dhe organizata ndërkombëtare

- **Takimi me Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Tiranë** – kërkesa për mbështetje institucionale për harmonizimin ligjor Kosovë–Shqipëri dhe njohjen e përkohshme të licencave profesionale deri në themelimin e odave homologe.
- **Takimet në kuadër të projektit GIZ / BE** – takime të rregullta pune me GIZ dhe MMPHI në kuadër të projektit “Përkrahje për Reformat në Procesin e Integritimit Evropian”, përfshirë prezantimin final të platformës eLicenca.

12. RAPORTI FINANCIAR

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, si dhe me Statutin e OIRK-së për periudhën e përkohshme, Oda ka obligim të sigurojë administrimin e rregullt financiar, transparencën dhe raportimin periodik të buxhetit në kuadër të kompetencave të saj institucionale.

Informatë: Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, Statutin e OIRK-së, si dhe në përgjigjen zyrtare të Komisionit Mbikëqyrës për Themelimin dhe Funksionalizimin e Odës (KMTHO), ju njoftojmë lidhur me dilemen nëse buxheti i OIRK-së për vitin 2026 duhet të miratohet në Kuvend. Sipas Ligjit Nr. 08/L-012, gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës, mjetet për themelimin dhe funksionimin e Odës sigurohen nga Ministria përkatëse në formë të grantit, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e financave publike. Në këtë kuadër, buxheti dhe financimi i Odës në periudhën e përkohshme janë të lidhura drejtpërdrejt me grantin qeveritar dhe administrohen sipas marrëveshjeve financiare ndërmjet Ministrisë dhe Odës. KMTHO, në interpretimin e tij zyrtar përmes email-it, ka sqaruar se gjatë periudhës së përkohshme buxheti i Odës caktohet dhe miratohet nga Ministria në përputhje me Nenin 42 të Ligjit, dhe si i tillë nuk ka nevojë të miratohet nga Kuvendi i Odës. Shuma dhe mënyra e shpenzimit të mjeteve të grantit janë të përcaktuara në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Ministrisë dhe OIRK-së, ndërsa kontrolli financiar ushtrohet nga organet shtetërore kompetente. Po ashtu, KMTHO ka theksuar se Oda gjatë periudhës së përkohshme nuk ka detyrim ligjor për auditim të pavarur, për shkak se financimi realizohet përmes grantit qeveritar dhe mjetet publike i nënshtrohen mekanizmave të kontrollit shtetëror. Për rrjedhojë, për vitin 2026, përderisa OIRK vazhdon të financohet në kuadër të periudhës së përkohshme përmes grantit qeveritar, buxheti caktohet dhe miratohet nga Ministria, ndërsa Kuvendi i OIRK-së njoftohet dhe informohet për planifikimin dhe shfrytëzimin e mjeteve financiare, pa qenë e nevojshme miratimi formal i buxhetit nga Kuvendi në këtë fazë.

Për zbatimin e këtyre parimeve, Bordi Drejtues ka miratuar Procedurën e Ekzekutimit të Buxhetit për periudhën e përkohshme, dokument që përcakton qartë kategoritë buxhetore, rregullat e ekzekutimit të mjeteve, autorizimet, evidencimin e shpenzimeve dhe raportimin financiar të detyrueshëm. Sipas vendimit të Bordit, shpenzimet lejohen vetëm brenda kategorive të përcaktuara në Memorandum dhe çdo devijim kërkon autorizim paraprak nga MMPHI.

Në këtë kuadër, raporti financiar vjetor i bashkëngjitet këtij raporti si aneks i veçantë. Raporti përfshin të gjitha të dhënat mbi menaxhimin financiar të vitit 2025, duke përmbledhur:

- të ardhurat e realizuara nga anëtarësia, të cilat derdhen në llogarinë e mirëbesimit të menaxhuar nga MMPHI;
- shpenzimet e kryera sipas kategorive buxhetore, në pajtim me Memorandumin, Procedurën e Ekzekutimit të Buxhetit dhe vendimet e Bordit Drejtues;
- planifikimin buxhetor për vitin 2026, të hartuar në përputhje me funksionalizimin në rritje të OIRK-së dhe nevojat institucionale të vitit vijues.

Raporti financiar vjetor i bashkëngjitet këtij raporti si aneks i veçantë.

13. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM DHE REKOMANDIMET

Viti raportues paraqet vitin e parë të funksionalizimit dhe konsolidimit institucional të OIRK-së – një fazë thelbësore në të cilën është vendosur baza për ushtrimin e mandatit ligjor dhe statutar të Odës. Si institucion i ri rregullator në fushën e ndërtimit, OIRK është përballur me sfida të shumta fillestare, por njëkohësisht ka realizuar hapa të rëndësishëm në drejtim të ndërtimit të kapaciteteve profesionale dhe administrative, duke e vendosur veten si mekanizëm i domosdoshëm për garantimin e standardeve teknike, etike dhe profesionale në vend.

Gjatë këtij viti të parë, puna institucionale është fokusuar në katër shtylla kryesore të mandatit të OIRK-së, të përcaktuara në Statut dhe Ligjin Nr. 08/L-012:

- **licencimin e profesionistëve të fushës së ndërtimit**, si një mekanizëm themelor për rregullimin e ushtrimit të profesionit;
- **edukimin e vazhdueshëm profesional**, që siguron ngritjen e kapaciteteve dhe kompetencave të inxhinierëve të licencuar;
- **miratimin e akteve të brendshme rregullatore**, të cilat strukturojnë funksionimin e Odës dhe mekanizmat e saj;
- **digjitalizimin e shërbimeve**, si hap strategjik drejt modernizimit dhe rritjes së transparencës institucionale, një proces në të cilin është punuar intensivisht gjatë vitit raportues dhe që, sipas njoftimeve nga MMPHI, pritet të hyjë në funksion gjatë vitit 2026.

Për më tepër, OIRK ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione qendrore, odat homologe në rajon, universitetet publike dhe private, si dhe me sektorin privat, duke krijuar themelet e një rrjeti profesional që do të ndikojë në ngritjen e cilësisë së projekteve të ndërtimit dhe sigurinë e qytetarëve.

Sfidat kryesore të vitit të parë

Në përputhje me natyrën e institucioneve të sapothemeluara, sfidat e paraqitura gjatë vitit 2025 kanë qenë të shumta dhe komplekse. Ndër më kryesoret përmenden:

- **ngarkesa e lartë fillestare për licencim**, si rezultat i kërkesave të akumuluar dhe hyrjes në fuqi të detyrimit ligjor për licencë;
- **nevoja për rritje të kapaciteteve administrative**, për të përballuar volumin e lartë të aplikimeve dhe kërkesave të anëtarëve;
- **përmbyllja e proceseve të digjitalizimit**, që kërkon koordinim ndërinstitutional, zhvillim teknik dhe testim të plotë funksional;
- **kufizimet buxhetore dhe vonesat në sigurimin e mjeteve**, të cilat kanë ndikuar në ritmin e realizimit të disa proceseve;

- **ambientet e punës jo të duhura dhe të përkohshme**, sidomos gjatë muajve të parë, çka ka paraqitur sfida operative për administratën dhe organet e OIRK-së.

Këto sfida, megjithëse të pritshme për një institucion të ri, kanë ndihmuar në identifikimin e nevojave reale dhe në orientimin e prioriteteve të OIRK-së për vitet e ardhshme.

REKOMANDIMET DHE DREJTIMET STRATEGJIKE PËR VITIN 2026

Bazuar në përvojën e vitit të parë dhe në objektivat statutare të OIRK-së, rekomandohet që në vitin vijues të fokusohemi në këto prioritete:

- **finalizimin dhe zbatimin e rregulloreve të mbetura** (si rregullorja për prokurim dhe aktet tjera të domosdoshme për funksionim të plotë institucional);
- **konsolidimin e sistemit të EVP-së**, përmes hartimit dhe zbatimit të një kalendari të qartë vjetor që mbulon të gjitha drejtimit profesionale;
- **përforcimin e mekanizmave disiplinorë dhe etike**, duke siguruar funksionim të qëndrueshëm të Komisionit Disiplinor dhe Komisionit të Ankesave;
- **avancimin e bashkëpunimit rajonal dhe njohjes së ndërsjellë të licencave**, në përputhje me standardet dhe praktikat evropiane;
- **promovimin e zbatimit të Dokumentit për Çmimet Referente Minimale dhe Standardit të Unifikuar Profesional**, si dhe nxitjen e inkorporimit të tyre në Ligjin e Ndërtimit përmes një dispozite që u jep Odave kompetencë të drejtpërdrejtë për hartimin dhe zbatimin e këtyre akteve;
- **mbështetjen e zgjerimit të fushëveprimit të licencimit për drejtimit e reja inxhinierike**, duke vazhduar proceset informuese dhe harmonizimin profesional për këto fusha.
- **intensifikimin e takimeve koordinuese me Komisionin Mbikëqyrës të MMPHI-së dhe institucionet relevante**, me qëllim shtrirjen e plotë të zbatimit të Ligjit të Odave dhe forcimin e kontrollit të licencimit në fushën e ndërtimit.

BORDI DREJTUES

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Arsim Rapuca, Kryetar

Janar 2026